

**VENDIM**  
**Nr. 76, datë 28.1.2015**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT TE MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË, PËR DREJTORINË RAJONALE TË SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT, KORÇË, TË ANEKSIT TË GODINËS ME EMËRTIMIN “ISH-SHTËPIA E USHTARAKËVE”, ME VENDNDODHJE NË BULEVARDIN “REPUBLIKA”, KORÇË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 530, DATË 7.8.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit te Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit në Korçë, të aneksit të godinës, me sipërfaqe 219 m<sup>2</sup>, me emërtimin “Ish-Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Republika”, Korçë, për mjedise pune, për krijimin e kushteve për zhvillimin normal të veprimtarisë së funksionimit të këtij institucioni.

2. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Korçë, u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

3. Në vendimin nr. 530, datë 7.8.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për universitetin “Fan S. Noli”, në Korçë, të pronës nr. 549, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin “Republika”, Korçë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, aneksi i godinës, me sipërfaqe 219 m<sup>2</sup>, të hiqet nga sipërfaqja totale e pronës me nr. 549, me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me adresë bulevardi “Republika”, Korçë.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITETËRORE**

(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: **Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë**

**Shërbimi Kombëtar i Punësimit**

Bashkia Korçë

Fusha e përdorimit të pronës: **Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë**

| A        |                                      |                |                | B                                                                                                                |                                           |                                             | C                                                    |                                                 |                                                           |                                                                                                                                     |
|----------|--------------------------------------|----------------|----------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|---------------------------------------------|------------------------------------------------------|-------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Nr. rend | Zona kadastrale dhe indeksi i hartës | Nr. i pasurisë | Lloji i pronës | Emri i pronës, adresa                                                                                            | Sipërfaqja totale e pronës m <sup>2</sup> | Nga sip. totale, sa ndërtesë m <sup>2</sup> | Funksioni për të cilin përdoret prona                | Institucioni/enti me përgjegjësi administrative | Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit | Të thëna të tjera (shënime të veçanta)                                                                                              |
| 1        | 2                                    | 3              | 4              | 5                                                                                                                | 6                                         | 7                                           | 8                                                    | 9                                               | 10                                                        | 11                                                                                                                                  |
| 1        |                                      |                | Administrative | Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë, Bulevardi Republika (ish-Shtëpia e Ushtrakëve) Korçë | 219                                       | 219                                         | Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit | MMSR                                            | SHKP/DRSHKP. Korçë (në përdorim)                          | Ambientet ndodhen në aneksin e godinës së ish "Shtëpisë së Ushtrakëve" me vendndodhje në bulevardin "Republika" në përdorim të MMSR |

